



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

---

**K.DH.SHK.II.nr.1687/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë**, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” SH.A., me seli në Rr. ”Hazir Shala”, nr.4 në Prishtinë, kundër debitorit R.V., Furrë Buke, Arti, me adresë në rr.“Nazim Gafurri” në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.657/2022 të datës 23.10.2023, me datë 07.02.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e bazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” SH.A., me seli në Rr. ”Hazir Shala”, nr.4 në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.657/2022 të datës 23.10.2023 **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomikeme aktvendimin e atakuar KPPP.nr.657/2022 të datës 23.10.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimi i debitorit R.V. - Furrë Buke “Arti” ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr.62/21 i datës 19.01.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka është anuluar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës , konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktvendimi KPPP.nr.657/2022 të datës 23.10.2023 ta prishe dhe çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ose ta ndryshoje aktvendimin e kundërshtuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

**- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.62/21 të datës 19.01.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit nr. 180806 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbartjes së obligimeve të papaguara nga Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t’ia paguajë kreditorit shumën prej 2.418.43€ si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se debitori ka lidhur kontratë për shitblerjen e lokalit nga pronari R.M., ka filluar investimet mirëpo asnjëherë nuk ka arritur të shfrytëzojë lokalin pasi që pas përfundimeve të investimeve pronari i lokalit e ka prishur kontratën dhe e ka larguar debitorin. Lidhur me këtë çështje pronari i lokalit ka iniciuar padi në gjykatë me arsyetimin se është dëmtuar nga debitori ku pastaj Gjykata ka vendosur që ta refuzoj padinë e pronarit të lokalit R.M. Ka shtuar se debitori që nga vitit 2013 nuk e shfrytëzon këtë lokal dhe i njëjti ka bërë investime në vlerë prej 61.500€. Andaj, ka theksuar se kreditori për borxhin e pretenduar në shumën prej 2,418.43.00€ duhet ta kërkoj nga pronari i lokalit R.M. i cili e ka prishur kontratën e shitjes së lokalit dhe debitorin e ka larguar me dhunë nga lokali dhe këtë lokal debitori nuk e shfrytëzon që nga vitit 2013. I ka propozuar gjykatës që të anulohet Urdhri Përmbartimor P.nr.62/21 i datës 19.01.2021 si i pa bazuar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe të pa argumentuar, për faktin se për kreditorin nuk është me rëndësi si janë rregulluar raportet mes qiradhënësit dhe qiramarrësit e rëndësishme është se debitori është furnizuar me ujë. Ka theksuar se debitori nuk e ka dëshmuar me asnjë provë që ka barë kërkesë për pasivizim ose ndryshim të emrit siç e parasheh rregullorja e nr.10/2019 për standarde Minimale të Ujit në Kosovë, andaj pasi që debitori ti paguaj borxhet ndaj kreditorit mund të filloj procedurë gjyqësore ndaj personave të cilët i ka cek në prapësim për kompensimin e shumës së borxhit të cilën debitori i’ a ka paguar kreditorit. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe të obligohet që t’i kryej obligimet e tij.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së Parë , duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.657/2022 të datës 23.10.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimi i debitorit R.V. - Furrë Buke “Arti” ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr.62/21 i datës 19.01.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka është anuluar, duke vendosur me decidivisht si në arsyetim të aktvendimit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret rezulton se Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit nr. 180806 mbi e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk i plotëson kushtet që të qenë dokument i besueshëm për shkak se nuk i përmban elementet e kërkuara me nenin 29, 3 par.3 të LPP-së, konkretisht nga ky ekstrakt nuk përcaktohet në mënyrë të qartë objekti i detyrimit si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit. Deri tek ky përfundim Gjykata erdhi pasi që ekstrakti afarist i lartcekur, në hyrje të saj përcakton periudhën kohore nga data 01.01.2013 e deri më datë 13.01.2021 për borxhin në vlerë prej 2.418.43 EUR, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013, me ç'rast nuk dihet se saldo prej 1,592.83 EUR për cilën periudhë kohore është grumbulluar. Ndërsa kreditori, në propozimin për përmbarim nuk ka përcaktuar fare se për cilën periudhë kohore kërkon realizimin e borxhit nga ekstrakti i librave afarist nr. 180806. Prandaj , mbi këtë bazë e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe urdhrin P.nr.62/21 të dt.19.01.2021 e ka anuluar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimin të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se ekstrakti nuk është i përshtatshëm për përmbarim, sepse nga ekstrakti rrjedh se nuk është përcaktuar në mënyrë të qarte objekti i detyrimit si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.1 të LPP-së , në të cilën përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit nr. 180806 mbi e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk i plotëson kushtet që të qenë dokument i besueshëm për shkak se nuk i përmban elementet e kërkuara me nenin 29, 3 par.3 të LPP-së, konkretisht nga ky ekstrakt nuk përcaktohet në mënyrë të qartë objekti i detyrimit si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit, kjo pasi qe ekstrakti afarist i lartcekur, në hyrje të saj përcakton periudhën kohore nga data 01.01.2013 e deri më datë 13.01.2021 për borxhin në vlerë prej 2.418.43€, ndërsa

në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013, me ç'rast nuk dihet se saldo prej 1,592.83 EUR për cilën periudhë kohore është grumbulluar. Ndërsa kreditori, në propozimin për përmbaram nuk ka përcaktuar fare se për cilën periudhë kohore kërkon realizimin e borxhit nga ekstrakti i librave afarist nr. 180806.

Po ashtu, Kjo Gjykate vlerëson se në ekstraktin nr. 180806 dhe propozimin për përmbaram të kreditorit, nuk janë ofruar të dhëna e sakta lidhur me debitorin kjo pasi si debitor përshkruhet "R.V. – Furrë Buke Arti", por që as propozimi për përmbaram dhe as ekstrakti nga librat afarist nuk përmban numrin personal apo numrin e biznesit të debitorit, kërkesë ligjore kjo e paraparë me nenin 38 të LPP-së, ndërsa përkundër kësaj, organi përmbarues, nuk ka vepruar konform nenit 38, par.2 të LPP-së për ta kthyer në plotësim propozimin për përmbaram, e pastaj të vlerësoj se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbaramit.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbaramore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhomat e shkallës së dytë**  
**Ko.DH.SHK.II.nr.1687/23 dt. 07.02.2024**

**Gjyqtari,**  
**Ramush Bardiqi**